



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Nr. 5275 Prot.

Tiranë, më 08.09 . 2022

Lënda: Monitorimi i 8-mujorit të buxhetit për vitin 2022.

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tiranë

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të udhëzimit nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, bazuar në udhëzimin nr. 1 datë 10.1.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, po ju dërgojmë të dhënat mbi:

- a) Shpenzimet e realizuara për 8-mujorin e parë të buxhetit për vitin 2022 për të gjitha zërat buxhetor, duke përfshirë dhe institucionet e varësisë, rakorduar dhe me thesarin;
- b) Numrin e analizave/inspektimeve/etj, të realizuara për periudhën janar- gusht 2022;
- c) Realizimi i zërave buxhetor për 8-mujorin e parë përshkruar me shifra dhe në mënyrë narrative.

A) REALIZIMI I BUXHETIT 8- MUJORI VITI 2022

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nga ana buxhetore është i organizuar në 13 njësi shpenzuese (Drejtoria e Përgjithshme dhe 12 Drejtori Rajonale) të cilat administrojnë buxhet më vete për shpenzimet korrente (*paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative*), dhe një njësi shpenzuese për sa i përket shpenzimeve kapitale (*investimet*) ato janë të përqendruara në organin qendror në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU.

Në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kuadrin normativ si edhe nevojat e institucionit, janë menaxhuar me efikasitet fondet buxhetore të akorduara për AKU.

Fondet e Akorduara dhe të Realizuara 8/mujorin e parë 2022:

Llogaria Ekonomik	Buxheti fillestar	Ndryshimet gjate vitit		Buxheti total plan viti 2022	Realizimi i Buxhetit	Realizimi (%)
		Shtesa	Pakësime			
600	349,500,000		18,566,000	330,934,000	215,218,860	65
601	59,500,000		4,168,000	55,332,000	35,939,855	65
602	117,752,000		11,780,000	105,972,000	62,621,775	59
606	1,448,000			1,448,000	672,000	46
231	104,755,000			104,755,000	0	0
Totali	632,955,000	0	34,514,000	598,441,000	314,452,490	53

Realizimi i zërave të buxhetit në 8/mujorin e parë 2022 është 53% është një rezultat i kënaqshëm, Duke monitoruar të 13 njësitë shpenzuese të Autoriteti Kombëtar të Ushqimit, realizimi i buxhetit 8-mujor paraqitet si me poshtë shifrat janë të rakorduar dhe me degët e Thesarit:

Realizimi i zerave buxhetor per 8/mujorin e vitit 2022													Ne/000 leke	
NR	Kodi Institucionit	Emri institucionit	Investime Llogaria 231		Paga Llogaria. 600		ig.Shoq Llogaria. 600		p.operative Llogaria. 600		Llogaria. 606		TOTALI I BUXHETIT	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	1005118	AKU Qendrore	104,755		95,000	62,065	15,850	10,328	53,172	29,856	835	182	269,612	102,431
2	1005119	Drejtoria Rajonale Berat			14,690	9,094	2,450	1,535	2,600	1,357	0		19,740	11,986
3	1005120	Drejtoria Rajonale Diber			11,750	6,807	1,970	1,147	2,900	1,730	153	100	16,773	9,784
4	1005121	Drejtoria Rajonale Durres			22,290	14,643	3,730	2,445	7,000	4,750	0		33,020	21,838
5	1005122	Drejtoria Rajonale Elbasan			17,250	11,235	2,880	1,876	4,500	2,870	0		24,630	15,981
6	1005123	Drejtoria Rajonale Fier			15,890	9,902	2,660	1,648	4,500	1,732	100	100	23,150	13,382
7	1005124	Drejtoria Rajonale Gjirokastr			19,000	12,270	3,200	2,060	4,500	3,057	30	30	26,730	17,417
8	1005125	Drejtoria Rajonale Korce			27,230	16,906	4,547	2,824	6,000	3,550	0		37,777	23,280
9	1005126	Drejtoria Rajonale Kukes			14,530	9,363	2,425	1,563	2,600	1,651	0		19,555	12,577
10	1005127	Drejtoria Rajonale Lezhe			12,044	8,275	2,020	1,387	2,700	1,389	30	30	16,794	11,081
11	1005128	Drejtoria Rajonale Shkoder			18,550	12,107	3,100	2,017	4,500	2,978	120	120	26,270	17,222
12	1005129	Drejtoria Rajonale Tirane			42,990	28,486	7,200	4,762	7,000	5,208	120	50	57,310	38,506
13	1005130	Drejtoria Rajonale Vlore			19,720	14,066	3,300	2,348	4,000	2,494	60	60	27,080	18,968
TOTALI			0	0	330,934	215,219	55,332	35,940	105,972	62,622	1,448	672	598,441	314,453

B) REALIZIMI I INSPEKTIMEVE DHE ANALIZAVE 8- MUJORI VITI 2022

- Për periudhën 8-mujorit te parë 2022 janë kryer gjithsej **70.788** inspektime nga sektorët OJSH, OSH, MBIB dhe PIK .

Janë marrë masa administrative si më poshtë:

- 3.589 Paralajmërimë
- 250 Gjoha
- 36 Ndërprerje aktiviteti

SEKTORI	Janar – Gusht 2022			
	Nr. i inspektimeve	Gjoha (nr)	Paralajmerim (nr)	Ndërprerje aktiviteti (nr)
I Kontrollit Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OB Ushqimor	18,560	213	3,532	36
Mbrojtje e bimëve dhe imputeve Bujqësore	3,490	37	57	
Pikat e Inspektimit Kufitar	48,738			
Total	70,788	250	3,589	36

Inspektimet e planifikuara dhe realizuara sipas Planit Vjetor për vitin 2022 në 8- mujorin e vitit 2022, për Sektorin e Kordinimit të Kontrollit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Input-eve Bujqësore si dhe Sektorin e Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OB Ushqimor.

QARKU -	Inspektime të planifikuara në planin vjetor të inspektimeve 2022	Realizimi i inspektimeve Janar - Gusht 2022			% Realizimit nga Inspektimet të programuara nga plani në total	% Realizimit nga Inspektimet e programuara nga realizimi	% Realizimit të inspektimeve të paprogramuara nga realizimi
		Inspektime të Realizuara gjithsej	Nga këto				
			Inspektime të programuara	Inspektime të paprogramuara			
TIRANE	4366	5069	4055	1014	92.88%	80.00%	20%
DURRES	2361	2696	2292	404	97.08%	85.01%	15%
BERAT	1333	1393	1031	362	77.34%	74.01%	26%
SHKODER	1202	1152	1019	133	84.78%	88.45%	12%
VLORE	1912	1737	1469	268	76.83%	84.57%	15%
FIER	2051	1794	1599	195	77.96%	89.13%	11%
DIBER	595	681	560	121	94.12%	82.23%	18%
ELBASAN	1754	2034	1728	306	98.52%	84.96%	15%
KORCA	2215	1907	1567	340	70.74%	82.17%	18%
LEZHA	1084	1451	1274	177	117.53%	87.80%	12%
GJIROKASTER	1123	1232	1037	195	92.34%	84.17%	16%
KUKES	708	904	678	226	95.76%	75.00%	25%
TOTALI	20704	22050	18309	3741	88.43%	83.03%	17%

- Për periudhën 8-mujorit të vitit 2022 janë kryer analiza nga Laboratori Kimiko-Fizik , Laboratori Mikrobiologjik, Laboratori i Shëndetit dhe Mirëqënies së Kafshëve , Laboratori i Mbrojtjes së Bimëve. si me poshtë:

Janar-Gusht 2022	Sherbimet Laboratorike								Origjina e Mostrave			Total		Jokontrollimi	Problematika
	Fiziko-Kimike		Mikrobiologjike		Kafsheve		Bimëve		ne:						
	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	PIK	Terren	Autokontroll	Mostra	Analiza		
Tiranë	544	1126	22	22	0	0	0	0	17	549	0	566	1148	2	Përmbajtja e mitave në prodhiminshi "suxhuk", Insekte e dëmtues në "Miell gruri"
Durrës	738	2185	35	46	0	0	21	21	597	197	0	794	2252	0	
Shkodër	284	832	39	49	0	0	0	0	74	249	0	323	881	2	2 mostra qumësht i papërpunuar (NPM)
Fier	243	523	37	39	0	0	0	0	0	280	0	280	562	1	1 mostër qumësht i papërpunuar (NPM)
Vlorë	83	252	4	4	0	0	0	0	25	62	0	87	256	0	
Gjirokastrë	421	1145	77	136	0	0	0	0	218	280	0	498	1281	0	
Korcë	772	1372	41	51	41	41	5	5	479	341	39	859	1469	50	39 Mastit Stafilokok, 1 Enterotoksemi, 7 analiza qumësht i papërpunuar (NPM), 3 analiza qumësht i papërpunuar (QS)
TOTAL	3085	7435	255	347	41	41	26	26	1410	1958	39	3407	7849	55	

Të dhënat mbi origjinën e mostrave

- 41.4% janë nga kontrollet zyrtare në Pikat e Inspektimit Kufitar;
- 57.5% nga kontrollet zyrtare në terren;
- 1.1% të rasteve për analiza vetëkontrolli.

C) REALIZIMI I BUXHETIT 8-MUJOR TË VITIT 2022 SIPAS LLOGARIVE

Realizimi i zërave buxhetor për 8-mujorit të vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Realizimi i zërave Buxhetor 8-mujori të vitit 2022

Llogaria Ekonomike	Buxheti total plan viti 2022	Realizimi i Buxhetit (2022)	Realizimi (%)
600	330,934,000	215,218,860	65
601	55,332,000	35,939,855	65
602	105,972,000	62,621,775	59
606	1,448,000	672,000	46
231	104,755,000	0	0
Totali	598,441,000	314,452,490	53

1. **Realizimi i buxhetit 8-mujor 2022 në llogarinë 600 dhe 601** është në masën 53%, si rezultat i vendeve vakant në stafin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, nga 433 punonjës me strukturë numri mesatar i punonjësve ka qene 423 , si dhe janë paguar dhe 4 punonjës me kontratë në periudhën Mars, Gusht 2022.
2. **Realizimi i buxhetit 8-mujor llogaria 602** është në masën 59%, janë bërë likuidimet në lidhje me shërbimet bazë të institucionit siç janë
 - “*Shërbime nga të tretë*” të cilat janë në vlerën **22.661.222 lekë** ku përfshihen pagesat për shërbimet si Energji elektrike, Ujë, Shërbim postar, Shërbim i sigurimit dhe ruajtjes së objekteve, Internet dhe Shërbime të tjera ku vlerën më të madhe ne ketë shërbim e zënë analizat e kryera në ISUV, Enti farërave, etj.
 - “*Shpenzime për qiramarrje*” në vlerën **7.889.967 lekë** janë pagesat e qirasë për zyrat e inspektorëve veterinarë në pikat doganore dhe për ambiente me qira për Drejtorinë e Përgjithshme.
 - “*Shpenzime transporti*” në vlerën **3.683.656 lekë** janë pagesat për shpenzimet e sigurimit të mjeteve të transportit, taksa, kolaudim, etj, të cilat janë bërë gjatë tremujorit të parë 2022. Shpenzime të cilat janë bazë për funksionimin e mjeteve të institucioneve të AKU-së.
 - “*Materiale dhe Shërbime të Përgjithshme*” në vlerën **6.573.116lekë**, janë pagesa Kancelari, Materiale pastrim dezinfektim, Toner, në disa Drejtori Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit janë bërë prokurimet për këto zëra.
 - “*Shpenzime të tjera operative*” në vlerën **2.871.551 lekë** , janë pagesa për detyrime gjyqësore, shpenzime për honorarë, etj.
 - “*Shpenzime udhëtimi*“ në vlerën **3.153.976 lekë** në këtë zë përfshihen pagesat për “*Shpenzime udhëtim e dieta brenda vendit*” ,shpenzimet që të gjithë institucionet e varësisë kryejnë për pagesën e dietave të punonjësve të tyre që largohen me punë jashtë vendbanimit të tyre. *Shpenzime udhëtim e dieta jashtë shtetit*” përfshihen udhëtimet e punonjësve për trajnime dhe pjesëmarrje në work-shope, konferenca jashtë vendit.
 - “*Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale*” në vlerën **2.961.600 lekë** në këtë zë përfshihen pagesat për “*Shpenzime për ekzekutim vendimesh gjyqësore të punonjësve të larguar nga puna*” për mos krijimin e detyrimeve te prapambetura.
 - “*Materiale dhe shërbime speciale*” në vlerën **10.567.347 lekë** në këtë zë përfshihen pagesat për “*Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik*” “*Shpenzime për uniforma*”, “*Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik*” përfshin prodhimin e dokumentacionit specifik që përdoret në Pikat e Kalimit Kufitar dhe nga inspektorët dhe sektorët e tjerë të DRAKU certifikata të eksportit. “*Të tjera dhe materiale dhe shërbime speciale*”. Në tre vitet 2023-2025 vlerën me të madhe të kësaj llogarie e përfshin akreditimi i laboratorëve të AKU për vitet 2023-2025. Sipas një kostoje sa më poshtë sqarohet me një grafik (bashkëngjitur dhe relacioni i Sektorit të Koordinimit dhe Mbështetjes së Laboratorëve në bashkëpunim dhe me 7 laboratorët e DRAKU).
 - “*Shpenzime Mirëmbajtje të zakonshme*” në vlerën **2.259.340 lekë** në këtë zë përfshihen pagesat për shpenzimet të mirëmbajtjes dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të institucioneve të AKU-së dhe kryesisht të mjeteve të transportit , pajisjeve kompjuterike, pajisjeve laboratorike, pajisjeve te zyrave.

Në llogarinë 602 nuk janë marre në konsideratë obligimet e kontratave të shërbimit në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit realizim i cili shkon në masën 82%.

Theksojmë se, duke marrë në konsideratë pakësimin e buxhetit në llogarinë 602 në vlerën 11.780.000 lekë, do të ndikojë dhe në realizimin e disa objektivave siç janë marrja e mostrave dhe analizimi i tyre në institucione të tjera. Lutemi rishikimin e mundësisë që plani i marrjes së mostrave të realizohet dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të mos paguajë në institucionet të cilat janë në varësi të MBZHR, pasi mbetjet nga prokurimet do të përdoren për likuidimin e detyrimeve të krijuara rishtazi gjatë vitit 2022, siç janë vendimet gjyqësore, etj. Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për sa më lart i është drejtuar MBZHR për mbështetje me fonde në këtë llogari.

3. **Realizimi i buxhetit 8-mujor në llogarinë 606 është realizuar në masën 46 % dhe vlerë 672.000 lekë.** Janë kryer pagesa për buxhetet familjare si shpërblim për dalje në pension, shpërblim për kalim sëmundje të rëndë dhe shpërblim për humbjen e të afërmeve.
4. **Realizimi i buxhetit 8-mujor në llogarinë 231, në këtë zë nuk kemi realizim pasi nuk janë lidhur Kontratat për tre projektet e kësaj llogarie :**
 - Projekti “Pajisje specifike për grupet e inspektimit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” në vlerën 45.000.000 lekë, është procedurë e cila ndiqet nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka depozituar kërkesën , specifikimet teknike si dhe fondin limit pranë kësaj Agjencie dhe është në pritje për lidhjen e kontratës.
 - Projekti “Pajisje ftohëse dhe ngrirës (frigorifer) për Sektorët e laboratorëve dhe PIK të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” në vlerën 3.600.000 lekë, është procedurë e cila ndiqet nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka depozituar kërkesën, specifikimet teknike si dhe fondin limit pranë kësaj Agjencie dhe është në pritje për lidhjen e kontratës.
 - Projekti “Blerje pajisje laboratorike për laboratorin të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Tiranë” në vlerën 56.155.000 lekë është procedurë e cila ndiqet nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka hartuar kërkesën dhe specifikimet teknike dhe është në proces të studimit të tregut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

